

# STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE

## Fine Travel Albania

### Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë"

### Kreu I - Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1:

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 27/10/2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: FINE TRAVEL ALBANIA - SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë : **-ARMAND FERRA** Numër personal **H50905109K**:

#### Neni 2:

#### Objekti

#### Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Operator Turistik , organizim udhëtimesh individuale dhe në grup për shtetas shqiptare dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit.
- Organizim eventesh, konferencash, kongresesh, panairësh, udhëtime incentivuese të porositur nga individë ose kompani, shqiptare ose të huaja
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash dhe pasagjerësh brenda dhe jashtë vendit.
- Shit blerje dhe dhënie me qira automjeteve, pronash të luajtshme dhe të paluajtshme
- Ndërmjetësim kundrejt komisionit për palë të treta në fushën e shërbimeve turistike, shit blerjes së mallrave dhe shërbimeve, dhënies me qira të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme
- Shërbime konsulence biznesi dhe konsulence në turizëm
- Menaxhim pronash dhe shërbimesh për të tretë

#### Neni 3:

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do jetë: PA AFAT

#### Neni 4:

#### Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Tish Dahia, Kompleksi Kika, H1, Ap.4, Tiranë, Shqipëri. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon : [contact@finealbania.com](mailto:contact@finealbania.com)

### Kreu II - Kapitali

#### Neni 5

#### Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në, kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

**1. Ortaku i vetëm themelues : ARMAND FERRA** që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë  
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose natyrë.

#### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe në natyrë, nëpërmjet vendimit të asamblesë së ortakëve me shumicën e parashikuar për ndryshimin e këtij akt statuti.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim bazuar në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statudit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**


### **ORGANET VENDIMMARRESE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statudit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për pikat e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statudit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- j) raste të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme, përveçse kur është ortak dhe administrator .

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, ose afat kohor me të njëjtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Në rastin e ortakut të vetëm afati kohor i thirrjes së asamblesë nuk vlen.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij Ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si;

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve dhe drejtuesit teknik;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, drejtuesit teknik përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Administrimi


(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë me një afat 5 vjeçar nga data e këtij akt themelimi.

#### **Te dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:**

-ARMAND FERRA



## Neni 13

### Kompetencat e Administratorëve

#### **Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:**

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



- Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e admirojnë bashkërisht shoqërinë.
- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.


#### **Neni 14**

#### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjate administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit me pasojat përkatëse.

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;  
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;  
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;  
ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;  
d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratoret kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit ,, Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - g) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në baze të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.



Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV - Viti financiar - ekspertët**

##### **Neni 15 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 16 Ekspertët**

Eksperti caktohet nëse e kërkon ligji ose asambleja dhe ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.


#### **Kreu V - Prishja riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 17 Prishja dhe Likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 tel ligjit 11129723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.



Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 18**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 19**  
**Baza Ligjore**


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 20**  
**Mosmarrveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

**FINE TRAVEL ALBANIA**



Emër mbiemër  
(nënshkrimi)